



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

ISHMP operacion blic në Fushë-Krujë për mbylljen e 21 furrave gëlqere

2017-03-16 02:25:00



Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve ndërmori sot operacionin blic për mbylljen e 21 furrave të gëlqeres funksionale në zonën e Fushë-Krujës.

Operacioni i kryesuar nga ISHMP dhe mbështetur nga IKMT dhe Policia e Shtetit do të vijojë për disa ditë deri në mbylljen e plotë të të gjitha furrave në këtë zonë.

Për herë të parë mbyllja e furrave të gëlqeres nga ISHMP u realizua në vitin 2013 kur u identifikuan 220 furra gëlqere funksionale në këtë zonë.

Prej aksioneve të vazhdueshme, në vitin 2015 numri i tyre u ul në 110 furra gëlqere, ndërsa sot falë punës së inspektorëve të mjedisit janë aktive vetëm 21 furra gëlqere, të cilat do të mbyllen deri në përfundim të këtij aksioni.

Kryeinspektori i ISHMP-së z.Ergys Agasi paralajmëron dhe garanton qytetarët se çdo tentativë e rihapjes së këtyre aktiviteteve të paligjshme do të ndëshkohet maksimalisht. Për këto aktivitete të paligjshme në kundravajtje me ligjin, të cilat rrezikojnë shëndetin e qytetarëve, por edhe ndotjen e mjedisit, do të ketë ndëshkime maksimale dhe nuk do të lejohen të ushtrojnë aktivitetet në kundravajtje me ligjet dhe normat mjedisore.